b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

² Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Nr.	Emërtimi	Specifikimet teknike
1.	Flaut Piccolo	FLAUT PICCOLO - Philipp Hammig 650/4 ose ekuivalent me të - Bukinë e prerë me dorë nga dru Grenadilla (Dalbergia Melanoxylon) i stazhonuar Modified Wave Thin - Trup i bërë nga dru Grenadilla (Dalbergia Melanoxylon) i stazhonuar - Çelësa prej argjendi sterling - Krahë çelësash të mprehtë - Susta çeliku blu - Mekanizëm i ndarë për notën MI

		• Mekanizëm për notën e lartë SOL# • Tapa S2 • LA-ja = 442 Hz • Punuar me dorë • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
2.	Flaut	FLAUT – Wm. S. Haynes Q 9K Gold ose ekuivalent • Instrument: Flaut professional koncertal • Seria: Haynes Q Series – Q 9K Ar • Trupi: 9K ari (konstrukcion Q Series) • Mekanizmi: Mekanikë çelësash prej argjendi sterling (cilësi profesionale) • Bukinë: Haynes e punuar me dorë prej ari, prerje N cut • Pllaka e buzës: 9K ari • Riser: ari • Sistemi: Boehm system • Sistemi i çelësave: Model francez me vrima të hapura • Çelësi Sol i dalë • Dizajni i mekanizmit: Mekanizëm pa pin në dorën e majtë • Krahët e çelësave: French pointed arms • Susta: Susta prej ari të bardhë 10K • Vrimat e toneve të salduara • Akordimi: A = 442 Hz • Shkalla: Haynes profesionale për koncerte • Opsione: Mekanizëm i Mi split • Çelës trilli për Do# • Me zbritje në Si • Lehtësues për Mi lart • Tapa: Tapa profesionale të cilësisë së lartë (Haynes ose ekuivalent premium) • Kuti: Kuti profesionale e fortë e përfshirë • Aksesorë: Shkop pastrimi dhe set pëlhurash mirëmbajtjeje • Ndërtimi: Instrument i punuar me dorë • Gjendja: i ri, i papërdorur
3.	Oboe	OBOE - François Lorée Etoile cE+3 Full conservatory plateau system ose ekuivalente me të • Tonaliteti Do • Sistem konservatori i plotë me pllaka

		• Materiali i trupit Dru natyral grenadilla • Mekanika Çelësa prej metali të argjenduar • Çelësa oktave Oktavë e parë, e dytë dhe e tretë • Set i plotë çelësash trillimi • Çelësa rezonance Fa i ndarë dhe Si bemol i ulët • Lehtësues për Re të lartë I përfshirë • Mbështetje gishti E rregullueshme • Nyje lidhëse Me përforcim metalik të dyfishtë • Vidë rregulluese për lartësinë e Do-së së mesme • Vrima e brendshme Profesionale, e balancuar për rezistencë dhe intonacion • Nyja e parë e kokës Prej druri grenadilë • Nyja e dytë e kokës Prej materiali sintetik • Instrumenti dorëzohet me dy nyje koke • Përdorimi Orkestral dhe pedagogjik • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
4.	Klarinetë në Si bemol	KLARINETË – Buffet Crampon Divine BC1160L-2-0 ose ekuivalente me të • Tonaliteti: Sib • Sistem Boehm • Akordimi 440 / 442 Hz • Çelës shtesë për notën Mib dora e majtë • I prodhuar nga dru natyral i zgjedhur Grenadilla i stazhonuar (Dalbergia Melanoxylon) • 19 Çelësa • 6 Unaza • Mekanizëm dhe çelësa të veshur me argjend • Bucela dhe këmbana pa unaza, • Çelës shtesë për notën Fa të ulët • Kombinim i tapës Gore-Tex® dhe tapave prej tapeje natyrale • 2 Bucela të përfshira: 65 mm dhe 66 mm • Bukinë B40 .13 /88 • Morsetë dhe aksesore shtesë • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur

5.	Klarinetë në La	KLARINETË – Buffet Crampon Divine BC1260L-2-0 ose ekuivalente me të • Tonaliteti: La • Sistem Boehm • Akordimi 440 / 442 Hz • Çelës shtesë për notën Mib dora e majtë • I prodhuar nga dru natyral i zgjedhur Grenadilla i stazhonuar (Dalbergia Melanoxylon) • 19 Çelësa • 6 Unaza • Mekanizëm dhe çelësa të veshur me argjend • Bucela dhe këmbana pa unaza, • Çelës shtesë për notën Fa të ulët, • Kombinim i tapës Gore-Tex® dhe tapave prej tapeje natyrale, • 2 Bucela të përfshira: 65 mm dhe 66 mm, • Morsetë dhe aksesore shtesë • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
6.	Fagot	FAGOT – Yamaha YFG 812C ose ekuivalent me të • Dru Panje i stazhonuar mbi 10 vjet • Çelësat sistemi Heckel • Me këmbanë më të gjatë. • Mkanizëm dhe çelësa të lara me argjend. • Me çelësin e notës Re edhe Mi të regjistrit të lartë. • Me çelësin e pianos mekanike. Me çelësin ndihmës për notën La që mbyll pianon mekanike. • Çelsat në dorën e djathtë: notat Fa-Lab-Fa# me rrula. Mi-Sib-Fa#-Sol# me rrula. • Dora e djathtë nota Mi të jetë e lidhur me piano mekanike. • Dora e djathtë çelës për trillin e notes Do# • Çelës per trillin e notës Sib • Dora e majtë : Çelësat e notave Re Do La Do# (La+Do# me rrul) për regjistrin e lartë edhe pianos mekanike. Sib Si Do Re (Do+Re rrula)

		edhe çelësi ndihmës për mbyllje të notave Re+Do për regjistrin e ulët. • Çelësat për notat Re#-Do# (rrul) regjistri ulët per gishtin e vogël. • Çelës ndihmës për notën Re# trill regjistri i mesëm. • Vrimat e notave Mi Re Do Si La të jenë me tuba argjendi • Balanciere per Fagotin. • Dorezë. • 2 (dy) Esa - CN1, CN2 super bocal • Varëse per Fagotin. • Kutia të jetë për Fagot me këmbanë të gjatë edhe e versionit çantë shpine. • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
7.	Korno	KORNO – Gebr. Alexander 103 ose ekuivalent me të • Dopro • Tonaliteti Fa/ Si bemol • Diametri i Tubave : 12,1 mm, Mesatar • Diametri i Këmbanës: 310 mm (rreth 12.2 inç) • Këmbanë të çmontueshme • Madhësia e trupit të instrumentit Mesatar • Materiali: tunxh i verdhë (yellow brass) i llakosur • Sistemi kornos Kruspe (Kruspe Wrap) • Sistemi i çelësave me Minibal • Dorezë mbështetëse e dorës së majtë (handflipper) • Dorezë e zezë prej lëkure • Aksesore të përfshira, • Set lubrifikantësh (vaj, set pastrimi, graso tubash)

		• Bukinë rreth 17,5 dhe vrimë 4,5. • Kutia Kornoje version çantë shpine (kompakte) • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
8.	Trombë në Si bemol	TROMBË – Yamaha YTR 9335 NYS ose ekuivalente me të • Tonaliteti: Si Bemol • Materiali i Kambanës: Një pjesë e vetme, tunxh i verdhë (Yellow brass) • Diametri i Kambanës: 123mm (4-7/8") • Madhësia e tubit (Bore): ML 11.65mm (0.459") • Pesha: E rëndë (Heavy) • Veshja: E larë në argjend (Silver-plated) • Bukinë: TR-17B4 • Kutia: E përfshirë • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
9.	Trombon Tenor	TROMBON TENOR – Antoine Courtois Legend 420 AC420BH-1-0 ose ekuivalent me të • Tonaliteti Sib me çelës Fa • Mbështjellës e hapur • Valvula Hagmann • Lyerja llak transparent • Vrima: 0.547", e madhe • Këmbanë: 8.46", 1 copësh • Materiali i këmbanës tunxh i verdhë • Rrëshqitësja e brendshme nikel argjend • Rrëshqitësja e jashtme tunxh i verdhë • Bukinë AC 6.5AL • Hyrje Bosht i Madh • Kutia/Qese Kutia Deluxe me Fuqi të Fortë • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur

10.	Trombon Bas	TROMBON BAS – Antoine Courtois Legend 550 AC550BH-1-0 ose ekuivalent me të • Tonaliteti SIb/Fa/Solb/Re • Diametri i vrimës .562” / 14,28 mm • Rrëshqitës standard i jashtëm prej bronzi me mbështjellës nikël-argjendi • Hark i poshtëm prej bronzi me rreze të dyfishtë • Rrëshqitës i brendshëm i kromuar dhe i veshur me nikël, tub plumbi prej bronzi i ndërrueshëm • Kambana të ndërrueshme njëpjesëshe të punuara me dorë prej bronzi të verdhë ose prej bronzi të artë 9.5" • Dy valvola të pavarura me rrjedhje të lirë René Haggmann® në linjë me vrimë progresive • Lyerja i llakuar transparent • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
11.	Harpë me pedale	HARPË ME PEDALE – Salvi Iris Gold ose ekuivalente me të • Harpë Profesionale koncertale me pedale • Harpë me 47 Tela standard për orkestër simfonike. • Tensioni i telave i balancuar për rezonancë, projektim dhe qëndrueshmëri të intonacionit nën përdorim të rëndë. • Nga nota Sol 0 në oktavë të parë deri në notën Do 7 në oktavë të shtatë. • 7 pedale • Sistem pedalesh me dy veprime, tre pozicione • Lartësia 187cm (73.6") • Gjerësia 100 cm (39.4") • Pesha 42 kg • Gjerësia e kasës së rezonancës 55-56 cm (22")

		• Shtylla (kolona) gjatësia 187 cm prej druri kryesor Panje. Dekor i jahtëm ulliri dhe Palisandër • Qafa Gjatësi rreth 85-90 cm me dru Panje • Trupi me gjatësi rreth 135 cm. Dru kryesor Panje. Dekor i kashtëm Ulliri dhe Palisandër • Kasa e rezonancës me gjerësi rreth 57 cm. Materiali dru Bredh i kuq • Aplikim artizanal me fletë ari 23-24 k në shtyllë (kolonë) dhe/ose element dekorativë • Këllëf mbrojtës • Çelës akordimi (tuning key) • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
12.	Set Timpane orkestrale (5 timpane brenda setit)	TIMPAN – Bergerault Grand Symphonic ose ekuivalent me të • Sasia e timpanëve: Set me 5 (pesë) copë timpanë • Lloji i kazanit: Bakër i harkuar me çekiç. • Bakër i rrahur me çekiç • Bakër i lëmuar (Fiberglass) • Madhësia e kazanëve: • 32” (81.3 cm) ○ 29” (73.7 cm) • 26” (66.0 cm) • 23” (58.4 cm) • 20” (50.8 cm) • Pedali: Mekanizëm pedali i patentuar me veprim të balancuar • Kokat: Remo Renaissance me unazë alumini, film i rregullt • Unaza kundër të veshura me krom • Unaza e pezullimit e kromuar me 1 (një) flaxhë (kazan lundrues i lirë)

		• Bazë alumini e veshur me pluhur me këmbë me bazë më të gjera dhe rrotë të tretë të integruar • Rrota rrotulluese me kyçje të nivelit komercial, rrota rrotulluese me dy rrota • Amortizator: 6 (gjashtë) amortizatorë alumini ekstra të fortë të veshur me pluhur • Matës akordimi, heshtje, çelës akordimi • Mbulesë për çdo timpan • Akordues i imët • Rrota qëndruese
13.	Daulle e madhe (Bass drum)	DAULLE E MADHE (Bass Drum) – Adams BDV 36/22 Concert ose ekuivalente me të • Daulle profesionale (bass drum) për Orkestër Simfonike • Guackë (shell) prej druri Sofre (Mahogany) • Unaza druri të rrumbullakosura, të gjera 2" (5.08 cm) • Diametër: 36" (91.44 cm) • Thellësi: 22" (55.88 cm) • Stativ universal me pika fiksimi • Lëvizje 360° • Luga tensioni të ndara, me dizajn me masë të ulët për të maksimizuar rezonancën e trupit • Mbajtëse për cymbal • Membrana lëkurë fibre Remo Fiberskyn III • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
14.	Këmbana Tubolare	KËMBANA TUBOLARE – Adams BK 5203L ose ekuivalente me të • Diapazon tonal: 1.5 oktava, C5 – F6 • Këmbana tubolare profesionale për Orkestrër Simfonike • Akordimi: La-ja = 442 Hz • Materiali: Bronx të kromuar • Tuba: 38-39 mm diametër • Tubat: Filharmonik 1.5" (3.81 cm) speciale • Përmasat: 182 × 88 × 60 cm

		• Stativi: pneumatik i rregullueshëm në lartësi me mekanizëm fiksimi • Sistem akordimi GEN 2 për intonacion perkfekt dhe overtone • Përfshin: stativ, mbulesë dhe çekiç (mallets) • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
15.	Tamburino	TAMBURINO – Black Swamp T12-1 ose ekuivalente me të • Tamburinë profesionale për Orkestër Simfonike • Përmasat: 12” (30.5 cm) • Trup i fortë prej dru Ahu • 25 kapse kromi rreth kornizës për tensionin e lëkurës • Lëkurë viçi natyrale • 12 kllapa metalike kromi • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
16.	Pjata simfonike (Cymbals) 2 copë brenda setit	PJATA SIMFONIKE (Cymbals) – Istanbul Agop Super Symphonic ose ekuivalente me të • Pjata profesionale për Orkestër Simfonike • Madhësia: 20” (≈50.8 cm) • Pesha (për palë): Rreth 4.8 kg • Përfshin: rripa dore (hand straps) • Sasia në paketim: 1 çift me dy pjata simfonike • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
17.	Daulle Snare	DAULLE SNARE – Black Swamp Concert Black CM514BL ose ekuivalente me të • Daulle snare (Snare Drum) • Snare profesionale per Orkestër Simfonike • Madhësia: 5” (thellësia) × 14” (diametri) → ≈12.7 cm × 35.6 cm • Trupi: 7 shtresa (7-ply) i bërë me panje (maple) të njëjtë si në modelin e lartë të snare-ve BSP • Tingulli: i ngrohtë dhe rezonant, me snap të mjaftueshëm • Pamja: e zezë koncerti (Concert Black finish)

		• Mekanizëm tensioni (strainer): i hedhur me kallëp (Die-cast) • Unaza: çelik 2.3 mm (steel hoops) • Njësia snare: çelik i mbuluar me blu / çelik inox (Blue Coated / Stainless Steel snare unit) • Luga tensioni: luga hark me kallëp (Die-cast Arch lugs) • Membranë: Profesionale me cilësi të lartë (Renaissance head) • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
18.	Pjatë e varur (suspended Cymbal)	PJATË E VARUR (Suspended Cymbal) – Sabian HHX ose ekuivalente me të • Aleazh: B20 (80 % baker – 20 % zink) • Metal i rrahur me dorë • Madhësia: 18” (≈45.7 cm) • Tipi: e varur (përdoret si cimbale i vetëm, jo pjesë e një seti) • Materiali: Aleazh bronz premium • Tingulli: i thellë, kompleks, me rezonancë të gjatë • Përdorimi: për orkestër, solo dhe ensemble perkusioni • Pesha: mesatare (medium weight, për kontrollë dinamike të lehta) • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
19.	Kastanjeta 2 copë	KASTANJETA – Studio 49 RCA 2 Royal ose ekuivalente me të • Dy çifte me 4 copë në total kastanjeta profesionale për orkestër Simfonike • Madhësia: mesatare, orkestrale • Tipi: Kastanjeta në panel • Materiali: Dru Rozë (Rosenwood-Dalbergia stevensonii) • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur

20.	Trekëndësh (Triangel)	TREKËNDËSH (Triangel) – Grover Pro percussion TR-BPH-7 ose ekuivalente me të • Madhësia: 7” (≈17.8 cm) • Materiali: Bronze premium, sipërfaqe e goditur me çekiç (hammered) • Trekëndësh profesional për Orkestër Simfonike • Përmasa: model standard orkestral (të zakonshme për përdorim profesional) • Tingulli: i pastër, rezonant, me shpërndarje të mirë në orkestër • Përfshin mbajtëse të sigurt dhe mundësi të varjes • Përdorimi: për orkestër, ansamble, dhe solo perkusion • Gjendja Instrument i ri, i papërdorur
21.	Çantë dopio për dy klarineta	ÇANTË DOPIO PËR DY KLARINETA – Bam trekking double clarinet case 3028SN ose ekuivalente me të • Çantë dopio për dy klarineta (Sib dhe La) • Përmasat e brendshme: Klarinetë Sib Tubi i sipërm: 22 cm. Tubi i poshtëm: 25,5 cm. Këmbana: 10 cm. • Klarinetë La: Tubi i sipërm: 24 cm. Tubi i poshtëm: 28 cm. Këmbana: 10,5 cm • Përmasat e jashtme 47 x 37 x 15,0 cm. Pesha 2.6 – 3.1 kg. Ngjyra e zezë • Përbërja e brendshme prej shkumë poliuretani të injektuar me dendësi të lartë, që mbron instrumentin nga tronditjet termike. Hapësirë e dedikuar për 4 bucela. • Material i jashtëm Cordura 2000 denier, rezistent ndaj ujit. 2 rripa shpine të mbushur dhe të tërheqshëm. Rrip shpatullash me mbushje, i rregullueshëm dhe i heqshëm. Dorëzë “subway” për mbajtje dore. Zip i qëndrueshëm. Xhep i madh i pasmë i zgjatshëm. Xhep i jashtëm në pjesën e përparme për partitura • Çantë e re, e papërdorur

22.	Tela për Harpë me pedale (47 tela)	TELA PËR HARPË ME PEDLE (47 tela) – Bow Brand ose ekuivalente me të • Sol 0 – Fa#1 çelik i mbështjellë me bronz fosforik ose bakër • Sol 1 – Fa 2 çelik i mbështjellë me metal ose zorrë e fortifikuar me mbështjellje metali • Sol 2 – Fa 4 zorrë natyrale (catgut) • Sol 4 – Fa 5 Nylon premium / zorrë sintetike (synthetic gut) • Sol 5 – Fa 6 Nylon / Fluorocarbon • Sol 6 – Do 7 Nylon monofilament ose fluorocarbon
23.	Prerëse telash Harpe	PRERËSE TELASH HARPE - KNIPEX 74 01 160 ose ekuivalente • Tipi: Pinca prerëse diagonale (High Leverage Diagonal Cutter) • Gjatësia: 160 mm (6 1/4") • Materiali i trupit: Çelik krom-vanadium me cilësi të lartë (Chrome Vanadium steel) • Ndërtimi: I farkëtuar (forged), i trajtuar me vaj në disa faza (oil-hardened) • Nyja: Bosht i farkëtuar për punë të rëndë (forged-on pivot axle) • Tehet prerëse: Të ngurtësuar me induksion • Fortësia e tehut: ~64 HRC • Dizajni i prerjes: Prerje precize me kënd optimal për fuqi maksimale • Reduktim force: Rreth 20% më pak forcë krahasuar me pinca standarde • Kapacitet prerjeje: ○ Tel i butë: deri ~3.4 mm ○ Tel i fortë: deri ~2.5 mm ○ Tel çeliku (piano wire): deri ~2.0 mm

		• Përdorimi: Për tela shumë të fortë (përfshirë piano wire / tel harpash) • Sipërfaqja: E zezë e trajtuar (black atramentized) • Koka: E lëmuar (polished head) • Dorezat: Plastike ergonomike kundër rrëshqitjes • Pesha: ~178 g • Përdorimi: Profesional / industrial / luthier • Standardi: DIN ISO 5749 • Të reja, të papërdorura
24.	Këllëf me 3 pjesë për Harpë	KËLLËF ME 3 PESË PËR HARPË – Salvi Transport Cover Concert Grand Blue ose ekuivalente me të • Set këllëfi profesional për harpë koncertale me pedale (Concert Grand) • Sistemi: 3 pjesë (full transport set) • Cover për trupin e harpës (harp cover) • Cover për kolonën (column cover) • Cover për bazën (base cover) • Materiali i jashtëm: • Poliester 100% me shtresë PVC rezistente ndaj ujit • Mbushja: • Shkumë poliuretani me densitet të lartë (high-density foam) • Shtresë e brendshme e butë (plush polyurethane lining) • Mbrojtja: • Mbrojtje e plotë ndaj goditjeve mekanike dhe ndryshimeve termike • Sistemi i fiksimit: • Zinxhir i fortë (heavy-duty zipper)

		• Velcro dhe kapëse plastike për lidhje midis pjesëve • Transporti: • Doreza mbajtëse të shumta • Hapje për kapje të sigurt gjatë ngritjes • Ripa për transport (sipas konfigurimit të setit) • Ngjyra: Blu e errët (Salvi navy blue standard) • Detaje shtesë: • Logo Salvi e qëndisur • Dizajn i personalizuar për harpë Concert Grand (47 tela) • Përdorimi: • Transport profesional orkestral • Mbrojtje gjatë udhëtimeve dhe turneve • Gjendja: i ri, i papërdorur
25.	Karrocë (trolley) për Harpë me pedale	KARROCË (trolley) PËR HARPË ME PEDALE – Salvi Wheels Trolley ose ekuivalente me të • Tipi: Karrocë profesionale transporti për harpë me pedale (Concert Grand / Orkestrale) • Sistemi i rrotave: 2 ose 6 rrota (version standard ose stair-climber) • Përdorimi: Transport i sigurt i harpës në orkestër, koncerte dhe turne • Funksionaliteti i rrotave: • 2 rrota për përdorim në sipërfaqe të sheshta dhe skena • 6 rrota për ngjitje shkallësh dhe terren të pabarabartë • Korniza: Metal i përforcuar (steel/aluminium heavy-duty) • Mbështetje harpë: Strukturë ergonomike në formë U për stabilizimin e trupit të harpës • Sistemi i fiksimit: Ripa sigurie të rregullueshëm dhe të përforcuar

		• Stabiliteti: I lartë gjatë transportit horizontal dhe vertikal • Manovrimi: I lehtë në versionin 2 rrota, i sigurt në versionin 6 rrota • Pesha: • Version 2 rrota: i lehtë (~5–6 kg) • Version 6 rrota: më i rëndë (~10–11 kg) • Karakteristika shtesë: • Sistem “stair-climbing” në versionin me 6 rrota • Dizajn profesional për përdorim orkestral dhe turne • Stabilizim anti-rrëshqitje për harpën gjatë lëvizjes • Gjendja: i ri, i papërdorur
26.	Set shkopinj për Daulle të madhe (bass drum) 2 copë brenda setit	SET SHKOPINJ PËR DAULLE TË MADHE (bass drum) - Kaufmann 153 ose ekuivalent me të • Materiali i kokës së shkopit: lesh dele • Shkopinj profesionalë për Orkestër Simfonike • Të buta dhe të mëdha • Përbërja e kokës: Tapë, lesh dhe pambuk i butë • Diametri i kokës: 93 mm • Lartësia e kokës: 100 mm • Trupi i shkopit: Dru Ahu • Gjatësia totale: 43.5 cm • Pesha: 150 g • Të punuara me dorë (handmade) • Sasia: 1 palë me dy shkopinj. • Të rinj, të papërdorur
27.	Set çekiçesh për Këmbana tubolare 2 copë	SET ÇEKIÇËSH PËR KËMBANA TUBOLARE – Kolberg 844M ose ekuivalente me të • Përdorimi: për këmbana tubolare (tubular bells) • Tipi: Çekiçë profesional për Orkestër Simfonike 844M • Materiali i çekiçit: kryesisht nylon ose dru i butë (për tingull të pastër dhe rezonant) • Gjatësia: standard orkestral, rreth 22–23 cm

		• Diametri i çekiçit: i përshtatshëm për këmbana tubolare mesatare • Ngjyra: shpesh përdoret e kuqe ose e verdhë për diferencim të peshës ose nivelit të tingullit • Karakteristikat e tingullit: i pastër, me rezonancë të gjatë dhe shpërndarje të shpejtë të tingullit • Sasia: Set me dy çekiçe • Të rinj, të papërdorur
28.	Mbajtëse pjatash simfonike	MBAJTËSE PJATASH SIMFONIKE (Cradle Shape) – Kolberg 238 GB a2 ose ekuivalente me të • Gjerësia: 16 cm • Përdoret për: 1 palë pjata (cymbals) deri në diametër Ø 56 cm • Materiali: Metal i mbuluar me copë të leshtë ose fibra sintetike të trashë (ndalim i menjëhershëm i tingullit) • I përshtatshëm për diametrin e tubit: 16 mm • Pesha: 3 kg • E re, e papërdorur
29.	Tavolinë për perkusion	TAVOLINË PËR PERKUSION – Thomann PT 1000 ose ekuivalente me të • Model: Shumë i qëndrueshëm • Madhësia e tavolinës: 560 × 400 × 45 mm • Lartësia: e rregullueshme • Mbështetja: e mbushur me material, jo rrëshqitëse (padded, non-slip support) • Stativi: kromuar, me mbështetje të dyfishtë (chrome-plated, double braced stand) • Lartësia minimale: 53 cm • Lartësia maksimale: 96 cm • E re, e papërdorur

30.	Set shkopinj për Trekëndësh (Triangel) 10 copë brenda setit	SET SHKOPINJ PËR TREK5NDËSH - Grover Pro Percution set TB-D ose ekuivalente me të • Aleazh Deluxe 303 • Përfshin shkopinj të ndryshëm për intensitet të ndryshëm tingulli • 2 × TB1 – super të lehta (e verdhë): 3.2 mm × 22.5 cm • 2 × TB2 – të lehta (portokalli): 3.9 mm × 22.5 cm • 2 × TB3 – mesatare të lehta (e kuqe): 4.75 mm × 22.5 cm • 2 × TB4 – mesatare (jeshile): 5.5 mm × 22.5 cm • 1 × TB5 – mesatare të rënda (blu): 6.3 mm × 22.5 cm • 1 × TB6 – të rënda (e zezë): 7.1 mm × 22.5 cm • Përfshin: Çantë për ruajtje dhe transport • Të rinj, të papërdorur
-----	---	---

Specifikimet teknike për veglat muzikore janë hartuar mbi bazën e nevojës institucionale për furnizim me instrumente të nivelit të lartë profesional orkestral dhe koncertal, të domosdoshme për realizimin e aktiviteteve artistike dhe edukative në standard të avancuar interpretimiga Orkestra Simfonike Kombëtare e Republikës së Shqipërisë.

Veglat muzikore kërkohen për përdorim në formacione orkestrale profesionale dhe solistike, ku kërkohet stabilitet i lartë i intonacionit, homogjenitet i tingullit, reagim teknik i avancuar dhe kontroll dinamik i saktë.

Kërkesa për instrumente të nivelit profesional bazohet në nevojën funksionale për të garantuar:

1. interpretim të saktë muzikor në kontekst orkestral;
2. stabilitet tonal në të gjitha regjistrat;
3. homogjenitet të tingullit në ansambël;
4. reagim teknik të avancuar në repertor kompleks;
5. qëndrueshmëri në përdorim intensiv koncertal.

Instrumentet e niveleve studentore ose gjysmë-profesionale nuk përmbushin këto kërkesa për shkak të kufizimeve në mekanikë, intonacion dhe cilësi materiale, dhe për këtë arsye nuk janë të përshtatshme për përdorim orkestral profesional.

Specifikimet janë hartuar mbi parimet e mëposhtme:

-
1. nevojë reale funksionale dhe artistike;
 2. proporcionalitet me përdorimin e synuar;
 3. referim në standarde ndërkombëtare profesionale.

Instrumente frymore (Flaut piccolo, Flaut, Oboe, Klarinetë, Fagot)

Instrumentet frymore kërkohen për përdorim orkestral dhe solistik profesional dhe duhet të sigurojnë minimalisht:

1. intonacion të qëndrueshëm dhe të saktë në të gjithë diapazonin tonal;
2. reagim të shpejtë dhe kontroll teknik të avancuar;
3. timbër homogjen dhe të balancuar në ansambël;
4. mekanikë profesionale me precizion të lartë dhe toleranca të ulëta funksionimi;
5. materiale cilësore që garantojnë rezonancë dhe stabilitet;
6. përshtatshmëri për përdorim të vazhdueshëm koncertal dhe edukativ profesional.

Kjo kategori përfshin: Flaut Piccolo, Flaut, Oboe, Klarinetë dhe Fagot për të cilat kërkohet standard orkestral profesional i krahasueshëm me instrumentet e përdorura në orkestra simfonike simotra.

Instrumente tunxhi (Korno, Trombë, Trombon)

Instrumentet e tunxhit duhet të garantojnë:

1. projeksion të fuqishëm dhe të kontrolluar të tingullit;
2. stabilitet të intonacionit në të gjitha regjistrat;
3. balancë akustike në përdorim orkestral;
4. mekanizma me precizion të lartë (valvula ose slide);
5. materiale të qëndrueshme të standardit orkestral profesional;
6. rezistencë ndaj përdorimit intensiv dhe kushteve klimatike.

Kjo kategori përfshin: Korno, Trombë dhe Trombon të përshtatshme për repertor orkestral profesional dhe koncertal.

Harpa

Harpa duhet të sigurojë standard koncertal profesional duke përfshirë:

1. stabilitet të lartë të akordimit;
2. rezonancë të pastër dhe të balancuar në të gjithë diapazonin;
3. mekanizëm preciz të sistemit të pedaleve;

-
4. ndërtim nga materiale akustike cilësore;
 5. ndjeshmëri të lartë dinamike për interpretim artistik;
 6. lehtësi në montim, transport dhe përdorim skenik;
 7. përshtatshmëri për përdorim orkestral dhe koncertal profesional.

Instrumente perkusioni (Timpan, Daulle e madhe, Këmbana tubolare, Tamburinë, Pjata, Daulle snare, Pjatë e varur, Kasanjeta, Trekëndësh)

Instrumentet e perkusionit duhet të përmbushin:

1. qëndrueshmëri të lartë strukturore dhe mekanike;
2. kontroll të saktë dinamik dhe përgjigje ritmike të qartë;
3. materiale profesionale që sigurojnë cilësi të qëndrueshme tingulli;
4. stabilitet tonal dhe uniformitet në kontekst orkestral;
5. lehtësi në montim, transport dhe përdorim skenik;
6. rezistencë ndaj përdorimit afatgjatë dhe goditjeve të përsëritura.

Kjo kategori përfshin: Timpan, Daulle e madhe, Këmbana tubolare, Tamburinë, Pjata, Daulle snare, Pjatë e varur, Kasanjeta dhe Trekëndësh.

Specifikimet janë hartuar për të:

1. garantuar nivel të lartë artistik dhe teknik;
2. siguruar përdorim të qëndrueshëm orkestral;
3. minimizuar rrezikun e furnizimit me instrumente të papërshtatshme;

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë objektive, funksionale dhe jodiskriminuese, duke u bazuar në nevojat reale artistike dhe institucionale. Ato sigurojnë cilësi të lartë profesionale orkestrale dhe janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të performancës muzikore.

GARANCIA

Sa më lart cituar, periudha minimale e garancisë duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vjet nga data e marrjes në dorëzim dhe nënshkrimit të procesverbalit të pranimi të të gjithë mallrave objekt prokurimi.

Për harpën koncertale dhe timpanët profesionale garancia minimale duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) vjet për elementët strukturorë dhe mekanikë kryesorë. Garancia duhet të mbulojë riparimin dhe/ose zëvendësimin e pjesëve me defekt që rrjedhin nga aspekte prodhimi, materiali, montimi etj., gjatë përdorimit normal profesional të mallrave objekt prokurimi. Operatori ekonomik duhet të sigurojë servis teknik, pjesë këmbimi dhe mbështetje teknike gjatë gjithë periudhës së garancisë.

Orkestra Simfonike e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor është e angazhuar në realizimin e shfaqjeve artistike të të gjitha drejtorive artistike të këtij institucioni (të Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë, Drejtorisë së Baletit dhe Drejtorisë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore), si brenda dhe jashtë ambienteve të institucionit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto shfaqje përfshijnë premiera dhe repertore të operave, musicaleve, operetave, galave, baleteve, koncerteve (simfonike, vokalo-simfonik, simfoniko-korale, mesha etj.) apo shfaqjeve ekskluzive duke përfshirë ndër të tjera edhe teatrin për fëmijë.

Të gjitha specifikimet teknike të përshkruara më sipër janë kërkesa minimale funksionale dhe performancë. Referencat eventuale ndaj standardeve, teknologjive ose konfigurimeve duhet të kuptohen si "ose ekuivalente".

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1.	Flaut Piccolo	Copë	1
2.	Flaut	Copë	1
3.	Oboe	Copë	2
4.	Klarinetë në Si bemol	Copë	2
5.	Klarinetë në La	Copë	2
6.	Fagot	Copë	2
7.	Korno	Copë	2
8.	Trombë në Si bemol	Copë	2
9.	Trombon Tenor	Copë	2
10.	Trombon Bas	Copë	1
11.	Harpë me pedale	Copë	1
12.	Set Timpane orkestrale (5 timpane brenda setit)	Set	1
13.	Daulle e madhe (Bass drum)	Copë	1
14.	Këmbana Tubolare	Copë	1
15.	Tamburino	Copë	1

16.	Pjata simfonike (Cymbals) 2 copë brenda setit	Set	1
17.	Daulle Snare	Copë	1
18.	Pjatë e varur (suspended Cymbal)	Copë	1
19.	Kastanjeta 2 copë	Set	1
20.	Trekëndësh (Triangel)	Copë	1
21.	Çantë dopio për dy klarineta	Copë	2
22.	Tela për Harpë me pedale (47 tela)	Set	1
23.	Prerëse telash Harpe	Copë	1
24.	Këllëf me 3 pjesë për Harpë	Set	1
25.	Karroçë (trolley) për Harpë me pedale	copë	1
26.	Set shkopinj për Daulle të madhe (bass drum) 2 copë brenda setit	Set	1
27.	Set çekiçësh për Këmbana tubolare 2 copë	Set	1
28.	Mbajtëse pjatash simfonike	Copë	1
29.	Tavolinë për perkusion	Copë	1

30.	Set shkopinj për Trekëndësh (Triangel) 10 copë brenda setit	Set	1
-----	--	-----	---

Afatet e lëvrimit: 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës

Të gjitha specifikimet teknike të përshkruara më sipër janë kërkesa minimale funksionale dhe performancë. Referencat eventuale ndaj standardeve, teknologjive ose konfigurimeve duhet të kuptohen si "ose ekuivalente".

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshirë nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*
Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/skeda teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikullin e ofruar, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit e mallit objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

4. Operatori ekonomik për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë një deklaratë garancie sipas afateve të parashikuara në Shtojcë nr.6. "Formulari i specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
